



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 409/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Fejzullah Rexhepi, Kryesues, Adnan Konushevcu dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e parashtruar nga kandidati për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, Sreten Ivanovic nga subjekti politik GI- Srpska, dega në Gjilan, paraqitur kundër Vendimit për shpalljen e rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 29.06.2017, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 01.07.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e parashtruar nga Sreten Ivanovic, kandidat për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e subjekti politik GI-Srpska, dega në Gjilan.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datën 30.06.2017 në ora 13:15, nga Sreten Ivanovic kandidat për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga subjekti politik GI-Srpska, në të cilën ankesë është pretenduar se në vendvotimin VV nr. 0428D/01D në Kmetovë, komuna e Gjilanit, ka pasur pa rregullsi gjatë numërimit të votave, pasi që sipas vëzhguesve thekson se ka fituar 63 vota në këtë vendvotim, ndërsa në procesverbal në vend që të ceket numëri 63 figuron numëri 003 i votave të fituara. Parashtruesi i ankesës PZAP-it i ka kërkuar që të bëjë rinumërimin e votave në vendvotimin e lartcekur dhe të vërtetohet numëri i saktë i votave, në mënyrë që të përmirësohet gabimi i bërë sipas procesverbalit .

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase parashtruesi i ankesës nuk ka ofruar asnjë dëshmi për ti vërtetuar ato pretendime edhe pse barra e te provuarit bie mbi parashtruesin e ankesës, ankuesi me asnjë provë nuk ka argumentuar parregullsitë e pretenduara. Ndërsa parashtrimet në ankesë lidhur me të gjeturat e vëzhguesit përkitazi me numrin më të madhe të votave të ankuesit Paneli nuk i morë për bazë për faktin se, këto parashtrime nuk u argumentuan me prova konkretisht deklaratat e vëzhguesve.

Paneli, në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse lidhur me pretendimet e paraqitura në ankesë, konstaton se ankesa në fjalë është e pa argumentuar me fakte dhe si e tillë e pabazuar. Parashtrimet në ankesë nuk paraqet bazë ligjore për parregullsi dhe për rrjedhojë as referencë ligjore për marrjen e vendimit në favore për ankuesin .

Sipas vlerësimit të Paneli ankesa e ankuesit nuk i plotëson standardet ligjore si dhe kërkesat e nenit 117 të LZP-së. Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në ankesë, konstaton se ankesa në fjalë është e pabazuar dhe si të tillë ankesën e ankuesit e refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.409/2017 më datën 01.07.2017.

Kryesuesi i Panelit
Fejzullah Rexhepi



Udhëzim Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*